

FATOS KONGOLI

I HUMBURI

ROMAN

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

I
HUMBURI

Roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Botimi i parë: “Dituria”, Tiranë, 1992
Botimi i dytë: “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
Botimi i tretë: “Ora”, Tiranë, 2002
Botimi i katërt: “Koha ditore”, Prishtinë, 2005
Botimi i pestë: “Toena”, Tiranë, 2008
Botimi i gjashtë: “Toena”, Tiranë, 2012
Botimi i shtatë: “Toena”, Tiranë, 2016
Botimi i tetë: “Toena”, Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Arlinda Rrush
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Ana Shema

ISBN 978 - 99943 - 1 - 430 - 6

© Autori dhe Shtëpia Botuese Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Mars 1991

Vjen një ditë kur njeriut i duket se i ka larë hesapet me botën, i është mbyllur cikli dhe nuk ka më kuptim të ripërtypë të kaluarën. Për më tepër kur në jetën e tij nuk ka diçka që do t'u vlente të tjerëve. Atëherë ç'kërkon, do të pyesni ju.

Asgjë. Thjesht një rrëfim.

Para dy muajsh, miku im Dorian Kamberi, inxhinier mekanik, baba i dy fëmijëve, një mëngjes ia hipi transoqeanikut "Partizani" dhe kapërceu detin familjarisht. Sikur të mos pendohesha çastin e fundit, mbase edhe unë sot do të gjendesha diku në ndonjë kamp refugjatësh në atë vend të ëndërruar, të quajtur Itali, ose gjetkë, nëpër Evropë, andej-këndeje, së bashku me turmat e bashkatdhetarëve të

mi. Por çastin e fundit, tek rrinim rrasur pas njëri-tjetrit, i thashë Dorianit se do të zbrisja. Dori mbase as që e ka marrë vesh ç'i thashë. Pas një odiseje peripecish nga qyteza jonë deri këtu, me ngordhjen përbrenda, fjalët e mia tingëllonin absurde, po të qe dikush tjetër në vend të mikut tim, do të më kishte flakur në det. Mirëpo Dori heshti. Më vështroi me sytë e zbrazur, e ndërkaq unë ndjeva në zverk ngrohtësinë e lagësht të urinës së djalit të tij të vogël, të cilin vazhdoja ta mbaja kalaqafë.

Pavendosmëria ime dukej sheshit. Jam i sigurt se në ato çaste zëri im, fytyra, shprehnin të kundërtën e asaj që thosha. Një përpjekje sado e vogël e Dorit, për të ma kthyer mendjen, do të kishte mjaftuar që unë të tërhiqesha nga një vendim i marrë pa e ditur as vetë përse. Në këtë mes malli për gurët e sokakut, si thuhet, s'hynte fare. Nuk ndieja asgjë dhe shpirtin e kisha më të zbrazur se sytë e Dorit. Ky s'lëvizi të më mbante. Dhe unë zbrita. Me zverkun të lagur nga urina e djalit të tij të vogël. Pastaj qëndrova i strukur në një cep të skelës duke vështuar grupet e fundit të ikanakëve, që nxitonin t'ia hipnin transoqeanikut. Kur vapori lëvizi e u largua sa nuk shquheshin më fytyrat e njerëzve, një lëmsh m'u mblodh në fyt. Me kokën midis duarve, dënesa. Gjatë, rëndshëm. Ato çaste nuk i rashë në të se kisha vite pa dënesur. Shpirti më qe tharë, prej kohësh kujtoja se s'do të kishte gjë në botë për të cilën të mund të derdhja një

pikë loti. Dikush që kaloi aty pranë më vuri dorën në sup, tha se puna ime rregullohej, pasdite nisej një tjetër vapor.

Ndaj të ngrysur, u ktheva në qytezë. Ashtu si largimi, edhe mbërritja ime nuk ra në sy. Syrgjyni i Dorian Kamberit familjarisht u mor vesh të nesërmen. Komentet për këtë nuk zgjatën shumë. Dikush e shau, dikush e mburri, dikush ia pati zili. Thashethemet e rastit i ndoqa me ndjesinë e atij hajdutit që ka marrë pjesë në një vjedhje e rri e dëgjon gomarllëqet e të tjerëve. Për herë të parë, në jetën time prej beqari dyzetvjeçar, ruajta brenda vetes një të fshehtë. Mbase të fshehtën e vetme që qyteza nuk ma mori vesh. Dhe s'do ta merrte vesh kurrë nëse s'do të më mbushej mendja të bëja këtë rrëfim. Që unë mund të nisesha e t'ia hipja vaporit për t'u zhdukur nga sytë këmbët, në përgjithësi në qytezë kurrkush s'do të habitej. Ama që unë të marr rrugët, të hipi në vapor, pastaj befas të zbres, jo, këtë kurrkush nuk do ta besonte. Edhe Dori, nëse e ka kuptuar ç'i thashë, nuk e ka besuar se vërtet do të zbrisja. Por ndoshta ka menduar se me plogështinë time do të isha për të një barrë më e madhe se familja e vet, prandaj nuk bëri as përpjekjen më të vogël për të më mbajtur.

Sidoqoftë, unë mbeta dhe të nesërmen këmbët më çuan në varreza. Do të mendoni se ja, më mbajtën për të mos ikur kushedi ç'varre të të parëve, kushedi ç'nostalgjira.

Kjo, fatkeqësisht, nuk është e vërtetë. Varret e të parëve, nostalgjitë, i respektoj. I kam zili të gjithë ata për të cilët këto nocione materializohen, kthehen në një forcë vepruese, si graviteti tokësor. Por unë e kam ndier veten të shkëputur nga ky lloj graviteti, të flakur e të braktisur në një boshllëk mospërfilljeje. Nostalgjitë u kthyen për mua në një luks mjegullor. Asnjë motiv i tillë s'ka lidhje me mosikjen time dhe vajtjen të nesërmen në varreza, ku nuk kisha shkelur ndonjëherë. Për të gjithë e në të gjitha pikëpamjet kam qenë e jam njeriu kot, i humbur.

Të nesërmen, në qytezë gdhiu një ditë e vrenjtur dhe mendja më vajti tek ikanakët në det. Pleqtë – jetoj me nënën dhe babanë në një apartament dy dhoma, kuzhinë – as e morën mundimin të më pyesnin për shkaqet e mungesës sime gjatë ditës së djeshme. Ata qenë mësuar me mungesa të tilla, prej vitesh s'më pyesnin më ku veja e me se merresha dhe prania ime në shtëpi natën u mjaftonte të flinin të qetë. Mendja, pra, më vajti tek ikanakët, ua qava hallin kur vura re kohën e vrenjtur, mirëpo disa procese biologjike në organizmin e njeriut kryhen pavarësisht gjendjes emotive: po më grinte uria. U veshja e dola dhe pleqtë i lashë tek pinin kafe kokë më kokë në kuzhinë, pasi u hodha përmes derës së hapur një “mirëmëngjesi” të mbytur.

Nuk besoj të gjendet në botë një qoshe më e pluhurosur se qyteza jonë. Pluhurin e sheh ngado: në tarracat e pallateve, mbi tjegullat e shtëpive të ulëta, nëpër rrugë, në trotuare, mbi lulet e bordurat e lulishtes së vetme në qendër, ku është i përhershëm si sheqeri pluhur mbi një tortë butaforike vitrine. Pluhuri të spërkat leshrat e kokës sapo del nga shtëpia, të futet në veshë, në vrimat e hundëve, ai të shtresohet në mushkëri e të ndjek kudo që vete, në klub, në restorant, deri brenda në shtrat. Kam qenë nja dhjetë vjeç kur pranë bregut të lumit në periferinë e qytezës, mbushur me shtëpiza dhe baraka gabelësh, u ngrit një fabrikë çimentoje – e tipit të shekullit të kaluar, thonë ata që marrin vesh – ku më shumë se çimento prodhohet pluhur. Më të vjetrit pohojnë se që nga ajo kohë nisi vdekja e ngadaltë e qytezës.

“Tani do të ndodhesha matanë detit”, mendova kur shkela në trotuar dhe më përshkoi një dridhmë. Pamja e qytezës në atë mëngjes të hirtë marsi m’u duk tmerrësisht e vjetër, aq e vjetër sa pata dëshirë të ngashërehesha. “Qyq, i thashë vetes, ç’të ka hipur?” Vajta drejt e në klub. Për të shuar urinë, duhej të kisha shkuar më parë nga qebaptorja “Bregu i lumit”, por kohët e fundit u fol se pronari i saj, Arsen Mjalti, ish-brigadier në fabrikën e çimentos, gatuante qofte me përbërje të dyshimtë. Gamën e dyshimeve, që nisnin me thashethemet për përdorim mishi lope të ngordhur e përfundonin

me mish qeni, e vërtetonin diarretë e klientëve nga qyteza, të cilët, në mungesë të fakteve për t'i dhënë një hu të shëndoshë Arsen Mjaltit, i bojkotuan qebaptoren, ku s'gjeje më veç ca miq të afërt të pronarit dhe klientë të rastit, transit nëpër qytezë. Mundet, e gjithë kjo të qe një zhurmë e kotë, e kurdisur nga dashakëqijtë ziliqarë; thuhej se ish-brigadierit po i ecte fjollë dhe, po të vazhdonte kështu, do të vinte aq para sa për pak vjet të blinte dhe vetë të famshmin hotel "Dajti".

Klubi qe bosh. Për fatin tim, tutje ekspresit të kafesë, në banak, sytë më zunë një varg shishesh me konjak "Skënderbeu", shijen e të cilit kisha kohë pa e provuar. S'e hapa gojën, banakierja e dinte ç'duhej të bënte. Fillimisht më vuri përpara një dopio, pastaj zjeu kafenë. Me filxhanin në njërën dorë e gotën në tjetrën, zura vend pranë xhamit. Aty pihet në këmbë, në ca tryeza të ngushta, të larta. Pa e zgjatur, mora konjakun dhe e ktheva me një frymë. Ndihesha i ligështuar, pre e një dëshire për t'u shkrirë në vaj, sa s'kishte forcë të më shpëtonte nga turpi i një skene qesharake në sy të banakieres, përveç konjakut. U lehtësova vetëm si ktheva dopion e tretë. Shpirti m'u qetësua, kafsha që më gërricte me thonj kraharorin u tulat dhe mora dopion e katërt, të cilën zura ta pija ngadalë, me gllënjka të vogla, duke e shoqëruar nga pak me kafenë ende të paprekur. Në rrugë njerëzit qenë të

rrallë ja ngase ai mëngjes turivrenjtur nuk ishte aspak miqësor për t'i ftuar të dilnin nga shtëpitë, ja ngase si ditë e diel ata vazhdonin të flinin ose thjesht të rrinin shtrirë me sytë në tavan, të sigurt se jashtë nuk i priste ndonjë gjë më interesante. Atë ditë, qyteza sikur bënte gjumin e vdekjes. Desha të shkoja te lulishtja, të vija ulërimën: Bashkëqytezarë të nderuar, zgjohuni! Të gjithë ikën, ju lanë pendët...

Nuk lëviza. Vazhdova të ktheja me gllënjka të vogla konjakun derisa e zbraza gotën dhe mora të pestën. Atëherë ndjeva nën lëkurë një butësi prej kadifeje. Kush nuk e ka provuar, s'mund ta kuptojë ç'është. Bota vjen në baraspeshë, arsyetimi kthjellohet. Në shpirt ngadhënjën drejtësia, më saktë ndjenja e drejtësisë, dhe je në gjendje të gjykosh qartë, pa komplekse, ose, të themi, pa frikë. Pikërisht atëherë m'u mbush mendja të shkoja nga varrezat. Unë s'kisha qenë kurrë në varreza, por ato çaste vajtja atje m'u duk veprimi më i natyrshëm që duhej të kryeja. M'u duk se qe një veprim i domosdoshëm, të cilin duhej ta kisha bërë prej kohësh dhe u llahtarisa kur mendova se në jetën time s'kisha vajtur ndonjëherë andej. Tek pija edhe gotën e pestë, unë nuk e dija se atje do të përplasesha me një njeri që në qytezë thirret me emrin Xhoda i Marrë. Po ta dija, s'do të kisha vajtur.

Ai po dilte nga hyrja pa flegra dyersh e varrezës së rrethuar nga një mur tullash të

kuqe me vrima, i lartë gati një bojë njeriu. Për këtë arsye nuk e vura re, ndryshe do t'i qeshë shmangur. M'u shfaq përballë befaz, siç i del njeriut në ëndërr një lugat. Ishte i parruar, flokët i tallandiseshin nga era. Përmes kapotës ushtarake të shkopsitur i dukej gjoksi leshator e për një çast mbeta i shtangur nën vështrimin e syve të tij. Në dorë mbante një shufër hekuri të gjatë. Qëndroi në vend përpara meje, me një pamje sikur diçka rrëmonte në kokë, dhe më përfshiu me një vështrim tërë urrejtje. Tek shihja sytë e tij gjak, m'u kujtua shprehja sipas së cilës të dehurit i hap rrugë edhe i marri. Mirëpo, duket, unë s'isha aq i dehur, kurse ai jo dhe aq i marrë: kuptova se në varreza mund të futesha vetëm po të kaloja përmbi të.

Me të kapërcyer çastin e shtangies, pata frikë se mos ai më qëllonte. Por edhe po të më qëllonte, vetëm do të strukja kokën midis supeve, do të ngrija duart në një përpjekje për t'u mbrojtur, si kisha bërë dikur, sa herë atij, si drejtor i shkollës, i hipnin vrundujt e tërbimit dhe për t'i shkarkuar gjente gjithmonë ndonjë viktimë midis nxënësve. Unë isha nga viktimat e preferuara. Kësaj radhe ai nuk më goditi as me shuplakë, as me shufër. Nuk më tha as maskara, as kopuk, as delenxhi. Më mbajti të mbërthyer me vështrimin e syve gjak dhe unë, pa i bërë dot ballë vështrimit të tij, vura majat nga thembrat.

1

Xhoda i Marrë ka qenë i pari që përdori X ndaj meje cilësimin “i pandreqshëm”. Edhe sot e kësaj dite e kam të gjallë skenën kur këtë fjalë ai ia përplasi tim eti në zyrën e drejtorisë, e ky, për kompensim, në shenjë miratimi, më dha një flakërimë turinjve, si të donte të më nguliste në kokë se isha vërtet ashtu si thoshte drejtori. Sikur drejtori të shtyhej më tej, për shembull të thoshte se unë isha një kriminel i lindur, megjithëse sapo i kisha mbushur të katërmbëdhjetat, im atë njëlloj do ta miratonte, me po atë flakërimë turinjve. Ka shpirt të butë, por atëherë e urreja, madje diçka më tepër se edhe vetë drejtorin.

Nuk më kujtohet në ç'rrethana e hëngra dajakun e parë nga Xhoda. Me siguri për

ndonjë nga ato arsyet e rëndomta në një shkollë qyteze, ku rrahja e nxënësve pranohej heshturazi dhe mësuesit e dinin se nga prindërit s'do t'u vinte ndonjë ankesë. Stilet e rrahjeve ishin të ndryshme, gjithsesi me kujdesin për të mos lënë shenja. Deri në klasë të pestë nuk isha rrahur. Thjesht sepse në katër klasat e para qëllova me një mësuese që s'e kishte këtë huq. Në klasën e pestë u bëmë me mësues të ndryshëm, huqet e tyre ishin të ndryshme dhe, duke kaluar nga dora në dorë, patëm rastin të bindeshim se gjatë katër vjetëve të parë kishim qenë fatlumë. Këtu nis e keqja. Unë s'isha rrahur ndonjëherë as në shtëpi, sepse, si thashë, im atë qe një tip i squllët, kreu i familjes në të vërtetë ishte nëna. Por edhe kjo s'e kishte huq të rrahurit. Kurse shokët e mi, shumica fëmijë punëtorësh, zhdëpeshin shpesh, në shtëpi e në shkollë.

Tani ndiej një shtrëngim në fyt kur kujtoj tmerrin me të cilin prisja çastin kur edhe unë do të rrihesha. Që do të vinte ky çast, as e vija në dyshim. Një gjë nuk e kisha çuar nëpër mend: se dajakun e parë do të ma jepte drejtori. Qe burrë i frikshëm, i vetmi të cilit edhe djemtë më kokëkrisur i shmangeshin. Kur dilte ai përpara shkollës, mësuesit vështronin tërë shqetësim nga turma e nxënësve dhe shpesh kam menduar se ata ia kishin frikën më tepër se ne, fëmijët. Këtë frikë e përfytyroja pak a shumë të ngjashme me timen, domethënë

frikë nga dajaku, atje, në zyrën e drejtorisë, ku s'isha futur ndonjëherë e s'më brente meraku të futesha. E kisha të qartë ç'pësonte një djalë po të thirrej atje.

Rrahja e parë qe për mua një traumë. Meqë nuk më kujtohet arsyeja, do të thotë se ka qenë një rrahje e kotë, fjala vjen për shkak të ankesës së ndonjë mësueseje, së cilës mund t'i kisha bërë zhurmë, ose të ankesës së ndonjë vajze, së cilës mund t'i kisha shkukur gërshetat. Shkaqet mund të qenë të tjera, nga më të ndryshmet, p.sh. mund të kisha qeshur ose lëvizur në rresht kur drejtori mbante fjalimet e tij përpara shkollës. Por mundet radha më erdhi për t'u rrahur thjesht, ngaqë, midis djemve të qytezës, qeshë nga të rrallët që ende s'e kisha provuar në kurriz zdrugun e drejtorit.

Pasi më shkuli veshët, flokët në tëmtha, pasi më dha ca shuplaka, shijen e të cilave do ta provoja shpesh, unë dola nga dera e drejtorisë pa lëshuar pikë loti. I çakërdisur, vajta drejt e në shtëpi, iu ankova tim eti. Isha në atë moshë kur fëmija beson se babai është qenia më e fortë e rruzullit, ajo qenie që e mbron dhe i del zot kur e marrin nëpër këmbë. Trauma ime nisi pikërisht me këtë. Deri atëherë unë nuk e njihja tim atë, e përfytyroja ndryshe nga ç'ishte. Do të duhej të kalonin pak vjet që të kuptoja se ai qëndrim i tij prej frikashi servil, nga i cili do të pësoja një zhgënjim të pariparueshëm, nuk përcaktohej vetëm nga karakteri i tij i squllët.

Të nesërmen, ai më shoqëroi në zyrën e drejtorit. Ta dija se do t'i përulej në atë mënyrë, nuk do t'i kisha treguar asgjë. Do të kisha pranuar të rrihesha dhjetë herë në ditë vetëm për të mos parë në sytë e tim eti frikën. Kjo skenë poshtërimi do të përsëritej shpesh me ndryshimin se më pas, im atë, që s'kishte vënë dorë mbi mua, do ta mësonte këtë zanat dhe do ta ushtronte me zell sa herë thirrej në shkollë nga Xhoda i Marrë për t'u vënë në dijeni të prapësive të mia, derisa mbërrita në klasën e shtatë, kur më në fund Xhoda shqiptoi cilësimin “i pandreqshëm”, unë hëngra flakërimën që përmenda më sipër e, me sa dukej, do të mbetësha i pandreqshëm përjetë.

Po le të kthehem te dita kur, pas rrahjes së parë, bëra zbulimin fatal: im atë nuk ishte i fortë, im atë ishte frikacak, njëlloj si të tjerët, si mësuesit, si të gjithë ata, që vetëm hija e Xhodës u kallte frikën. Isha dymbëdhjetë vjeç, në klasën e pestë. Tani, pas afër tridhjetë vjetësh, them se atë pasdite kam qarë sa për tridhjetë vjet. Dhe u arratisa nga shtëpia. Më gjetën të nesërmen duke fjetur në një stol, në Tiranë, në parkun përballë hotel “Dajtit”. Po vdisja nga lodhja, uria dhe tmërri. Nuk e dija se ky zhgënjim naiv ishte vetëm fillimi i një vargu zhgënjimesh. Por asnjërin prej tyre nuk e përjetova me atë intensitet tragjik. Sepse për mua babai kishte vdekur, kjo nuk riparohej

më. E meqë Xhoda kishte vrarë tek unë imazhin e babait, në mënyrën time vendosa të hakmerresha.

Atëherë banonim në të njëjtin apartament dy dhoma e kuzhinë ku vazhdojmë të banojmë edhe sot. Kam pasur e kam një motër pesë vjeç më të madhe. Por ajo nuk hyn në historitë e mia, nëse mund të quhen histori mediokritetet e jetës time. Sepse jeta ime ka qenë mediokre, jetë e një njeriu që nuk ishte kurrkush e nuk u bë dikush, një jetë anonime e shkrirë në anonimatën e një lagjeje të humbur, në një qytezë të humbur, sido që pranë kryeqytetit. Motra ka qenë vazhdimisht larg shtëpisë, si në kohën për të cilën bëhet fjalë, kur ishte konviktore në pedagogjike, si më vonë, kur filloi punën mësuese në një fshat verior, e mbeti andej.

Pallati ku banoj ndodhet pranë qendrës së qytezës. Përballë tij, matanë lulishtes, buzë sheshit të shtruar me asfalt, ndodhet një tjetër pallat, katin e parë të të cilit e zënë dyqanet e ushqimores, metrazheve, rrobaqepësia dhe klubi. Klubi i ka dhënë famë pallatit përballë, veçanërisht sheshit. Aty janë zhvilluar përleshjet më spektakolare midis individësh, ose grupesh rivale, përleshje që qyteza nuk i merrte seriozisht, ndoshta sepse jeta e saj s'mund të përfytyrohej pa ngjarje të tilla, ndoshta ngaqë njerëzit ishin mësuar me to,

siç u mësuan më vonë të shihnin filma përpara ekraneve të televizorëve. Në atë kohë në qytezë nuk ekzistonte televizori. Por kronika e zezë nuk mungonte. Shumica e njerëzve janë të mendimit se në larminë e kësaj kronike rolin vendimtar e ka luajtur pluhuri. Kur ai bashkohet me avujt e alkoolit, i tërbon bashkëqytezarët e mi. Ata janë shumë qejflinj e tepër xhelozë. Dy gjëra që s'mund të bashkëjetojnë në paqe. Pastaj, në përgjithësi, janë punëtorë me krahë e grushte të fuqishme. Ç'duhet më shumë për lulëzimin e një kronike të zezë? Sidoqoftë, ajo nuk u pasqyrua kurrë dhe sociologët për informacion mund t'u drejtohen organeve kompetente, ku shpresoj se nuk mungon një inventar i bëmave të qytezës. Ndoshta aty do të gjejnë edhe dosjen e njëfarë Thesar Lumi. Ky jam unë.

Them "ndoshta". Më duket sikur i jap pak si shumë rëndësi vetes duke e përfytyruar me një dosje të mundshme. Kam qenë e jam njeri i dorës së fundit dhe me këtë supozim këndellës për dosje nuk dua të fyej asnjërin nga ata që kanë pasur nderin të konsiderohen të denjë për një vlerësim të tillë. Më vjen mirë në këtë rast t'u besoj atyre zërave, sipas të cilëve ishe apo nuk ishe i rëndësishëm, mjafton të lëshoje hije mbi tokë për të pasur dosjen përkatëse. Nëse është kështu, do të isha i lumtur. Duket, në një kohë kur mendoja se nuk ekzistojnë në këtë botë, ka pasur të tjerë që mendonin ndryshe. Vërtet u jam mirënjohës.

Po i bëj qejfin vetes, pra, dhe po pranoj se e kam pasur një dosje. Nuk e di ç'mund të jetë shkruar aty dhe me siguri nuk do ta marr vesh kurrë. Veç një gjë mund ta them edhe unë: aty mungojnë faktet e vërteta, që në një mënyrë ose në një tjetër mund të konsiderohen veprime kriminale. Mirëpo ato s'mund të jenë në dosje, sepse, kur i kam kryer kam qenë fëmijë. I kam kryer në atë kohë kur, papritur, për arsye të pakuptueshme, im atë iu nënshtrua Xhodës së Marrë dhe humbi në sytë e mi. Kështu që unë vendosa të hakmerresha.

Në këtë pikë, në rrëfimin tim, vjen e futet Vilma. Më saktë kujtimi i saj. Vilma nuk është më. Prej kohësh.

2

Në trurin tim kohët bëhen lëmsh, e kam të vështirë të përcaktoj nëse qysh në fëmijëri Vilma ishte vajza, të cilën nuk kishte djalë që të mos e ëndërronte. E kam të vështirë të përcaktoj nëse qysh në fëmijëri ajo qe e destinuar të kthehej në mollë sherri e një qyteze sherrxhinjsh. Mendja ime e plogët mezi çan shtresimin e viteve, atë tis mjegullor, përtej të cilit zgjerohet universi i fëmijërisë dhe, më së fundi, mua më vjen para syve Vilma. Ajo që kam njohur kur isha i mitur dhe vetja më dukej burrë. Sepse në qytezë fëmijët hynin shpejt në burrëri.

Arrij ta shoh përtej asaj mjegulle. Ja tek është, prapa kangjellës prej hekuri. Rrinte vazhdimisht prapa kangjellës e prej andej

vështronte kalimtarët në rrugë. Kurse tani, prapa po asaj kangjelle, me të njëjtën ngjyrë si dikur, të zezë, kalimtarët mund të shohin tek rri ulur mbi stol, me sytë e ankhshëm prej të çmenduri, Xhodën e Marrë. Rri aty si një qen rojë. Çmenduria e tij vjen ngaqë kujton se Vilma ndodhet brenda dhe ai qëndron në gatishmëri me shufrën e hekurit në pritje të horrave. Qyqari nuk e ka ditur se Vilma ishte e paprekshme. Nuk e ka ditur se, kur vinte puna për Vilmën, hija e tij e frikshme nuk ishte në gjendje të zmbrapste kurrkënd. Diçka tjetër e ruante Vilmën dhe mjerë kush guxonte t'i prekte një qime floku. Edhe njëqind qen të vendoste Xhoda rreth shtëpisë, edhe njëqind zagarë të nxirrte në rrugë për ta shoqëruar, nuk do ta ruanin vajzën e tij më mirë se Fagu.

Më vjen keq. Më vjen të çmendem. Dua të flas për Vilmën e më del përpara Fagu. Dua të kujtoj sytë e saj të kthjellët me atë kaltërsi prej deti të thellë e më dalin përpara ca sy të zinj, vazhdimisht inatçorë. Mezi çaj dendësinë e mjegullës për të gjetur atë fytyrë të qetë inteligjente, kur ia beh fytyra përjetësisht e zymtë e Fagut. Derisa të më sosen ditët, këto fytyra do të vijnë tek unë si plotësim i njëra-tjetrës. Sapo më shfaqet njëra, vjen tjetra për ta përzënë. Janë pastaj çastet e atij makthi llahtar kur në ëndërr më shfaqet një imazh i përçudshëm, mbivendosja e dy fytyrave. Një Vilmafag ose një Fagovilmë. Gjithçka është e

prishur, pa ngjyrë. Gjithçka e shkatërruar, pa shprehje. Dekompozimi i vdekjes nuk do ta përçudnonte më keq një fytyrë. Ndonëse rrallë ky imazh vjen e më ngacmon nëpër gjumë, si për të më kujtuar se s'do të më shqitet kurrë. Unë zgjohem i mbytur në djersë, me zemrën gati për të më çarë kraharorin. Pastaj, nën pushtetin e makthit, dita më kalon i sëmurë, në klub. Në fund të dopios së parë diçka lëviz. Konjaku duket luan rolin e një lubrifikanti, i cili, përmes kapilarëve të gjakut, depërton në tru, duke lubrifikuar rrjetin e ndryshkur të subkorteksit tim. Atëherë diçka lëviz. Pas gotës së parë fillon rrëshqitja mbi njëra-tjetrën. Fillon dhe çlirimi im i mundimshëm. Por është ende shpejt. Zhvendosja ngec. Pothuajse e tërë goja e Vilmës me buzët e mbyllura vazhdon të mbetet e mbërthyer në darën e dhëmbëve të gojës së Fagut. Hunda sapo është zhvendosur pak, po ashtu sytë, konturet e fytyrës. Nga përvoja e di se pas gotës së dytë fytyrat janë gjysmë të mbivendosura, më saktë gjysma e fytyrës së Fagut mbulon gjysmën e Vilmës dhe mbeten të lira përkatësisht dy gjysmat e tjera. Atëherë nxitoj, këtë pamje s'mund ta duroj më. Si kthej dopion e tretë, fytyrat vetëm sa puqen pak e, pas dopios së katërt, ato ndahen e qëndrojnë veç e veç. Më duhet e pesta që portreti i vrenjtur i Fagut të zhduket dhe unë, së fundi, të mbetem vetëm për vetëm me Vilmën.

Ja tek është, prapa kangjellës. Ka veshur atë, fustanin e bardhë me kollan në mes. Krelat e flokëve të gjatë deri poshtë supeve i shndrisin. Janë të verdhë, prandaj nën diell, nga larg, duken si bashkë e artë. Ndihem i sigurt kur them se fustani ishte i prerë me copë si e fustanit të nuseve. Por plani që thura në kokë për t'u hakmarrë ndaj Xhodës nuk ishte rrëmbimi i saj për ta bërë nusen time, megjithëse, e veshur ashtu, ajo dukej nuse. Unë e shihja me sytë e një çapaçuli që ndiqte qëllime kriminale. Se ç'ishin këto qëllime, do ta them më poshtë. Më parë dua të pohoj një të vërtetë, atë të vërtetë që dihej nga të gjithë djemtë e qytezës të brezit tim, lukunia e dymbëdhjetë-trembëdhjetëvjeçarëve; Vilma ishte e zgjedhura e Fagut. Si e tillë, ajo ndodhej nën mbrojtjen vigjilente të klanit të tij, ku bënin pjesë tipat më kokëshkretë të shkollës. Këtë e dinte edhe Vilma. Ajo ishte sa unë, dymbëdhjetë vjeç. Kurse Fagu një vit më i madh, trembëdhjetë.

Nuk mund të them ç'mendim kishte Vilma për statusin që i kishin paracaktuar të tjerët. As që e vrisja mendjen për këtë. Ishte një konvencion që e pranoja si pranonim në një moshë më të vogël lodrën burrë-grua, ku çdo djali-burrë i takonte një vajzë-grua. Për veten time isha tërhequr nga këto lodra. Në atë kohë për mua këto qenë marrëzira, të padenja për një djalë, të cilit nuk i ka hije të rrijë në

shoqërinë e vajzave. Nëse Fagut i pëlqente të vazhdonte të luante me Vilmën lojën qesharake të burrit me gruan, punë për të. Sipas meje, kjo ishte një dëshmi komprometuese dhe më vinte habi se si klani i sherrxhinjve e gëlltiste dhe e pranonte Fagun për kryetar. Shkurt, Vilma s'do të hynte në jetën time në atë masë dhe në atë mënyrë, sikur mua të mos më kishte lindur në kokë ideja e hakmarrjes ndaj Xhodës.

Shpesh kërkoj të bind veten se e gjitha ka qenë lodër e rastësisë, fatalitet. Mirëpo, fatkeqësisht, si tërë brezi im, jam rritur pa ndjenja fetare. Kam dëgjuar të thonë se një fetar i mirë ngushëllohet e gjen qetësinë e shpirtit në shprehjen “kështu qe shkruar”. Një fetar i mirë beson në përcaktimin e fatit. Po unë që s'besoj në asgjë, me se të ngushëllohem? Unë nuk besoj se maskarenjtë e kësaj bote do t'i shlyejnë gjnahet në zjarrin e ndonjë ferri, nuk besoj se të mirët do të shpërblehen në parajsë. Megjithatë dua të besoj se ekziston një gjyq. Këtë e kam shpresuar si një ide mjegullore, ndryshe, në kotësinë e pafund të ekzistencës sime, s'do të kishte fije që të mund të më mbante në jetë.

U binda shpejt se hakmarrja ndaj Xhodës nuk qe punë e lehtë. Në fillim vendosa t'i thyeja xhamat e dritareve të shtëpisë, një vilë pak e mënjanuar nga qendra, rrethuar me kangjellë të lartë hekuri, ngarkuar tërë bimë e lule kacavjerrëse. Pranë saj kalonte një rrugë e

ngushtë dhe prej andej mund t'ia bëja xhamat e dritareve copë. Hoqa dorë sepse ditën, për shkak të lëvizjeve, ishte e pamundur të mos bije në sy. Kurse natën s'ma mbante nga frika e qenve. Natën nëpër qytezë endeshin një lukuni bastardësh. Variantin për t'i shtënë në sirtarin e tryezës në zyrën e drejtorisë një gjarpër, e hodha poshtë gjithashtu. Jo nga pamundësia për të siguruar një gjarpër, gabelët e bregut të lumit do të ma gjenin kur të doja. E gjykova të pamundur futjen në drejtori dhe akoma më të pamundur hapjen e sirtarit të tryezës së tij. Diheshin tri orvatje të tilla të dështuara. Më duhej, pra, të vrisja mendjen, të gjeja një mënyrë tjetër hakmarrjeje. Dhe e gjeta.

Ideja më erdhi në kokë rastësisht. Një ditë, në oborrin prapa shkollës, ku mblidhej klani i Fagut, pashë një skenë që, në të vërtetë, nuk ishte e jashtëzakonshme. Fagu po zhdëpte një djalë nga ata të lagjes së bregut të lumit, ndërsa sejmenët e tij rrinin e bënin sehir. Në largësi skenën e ndiqnin plot djem të tjerë. Gjithçka zhvillohej në heshtje. Pa nxjerrë zë, gabeli e duroi dajakun derisa Fagut iu mbush mendja dhe e lëshoi, pa harruar t'i jepte edhe një shqelm prapanicës. As mund të mendohet që ndokush t'i vinte në ndihmë gabelit. Qe një djalë i shkurtër, i fishkur, nga të rrallët bregalumas që e ndiqte shkollën rregullisht. E quanin Sherif. Ishte në klasë të pestë, në të pestën A, kurse unë në të pestën C. Rreth tij

dija edhe diçka tjetër e kjo, pak çaste më vonë, do të merrte rëndësi të veçantë. I ati, një gabel i shkurtër, po aq i tharë sa i biri, në periudha të ndryshme të vitit ngarkohej me shfarosjen e qenve. Thuhej se, po të mos i zhdukte ai, bastardët rrezik të shfarosnin qytezën. Për këtë qëllim përdorte copa mëlçish lope të helmatisura, me efekt të menjëhershëm.

Ra zilja e mbarimit të pushimit të madh. Oborri i pasmë kulloi në oborrin përpara. Sherifi mbeti në një qoshe. Nuk e di ç'më shtyu t'i thosha një fjalë, mëshira për të apo përbuzja ndaj Fagut. Sepse Fagun e përbuzja. Ishte edhe kapadai, edhe mizor. Atëherë mësova diçka që ma ngriti mendjen: Fagu e paskësh rrahur Sherifin ngaqë ky, një ditë më parë, paskësh ngacmuar në klasë Vilmën e kjo na qenkësh ankuar te Fagu. "Pisja, mendova, e bija e pisit." Pisa që të tre, i ati xhelat, ajo dhe rrugaçi që e ulte veten e kthehej në mashë në duart e një qurraveceje. Nuk m'u desh të lodhesha shumë për ta bërë Sherifin bashkëfajtor në veprimin tim.

Lodrën e luajta me një hipokrizi të pashembullt.

Them hipokrizi. Në atë kohë kësaj fjale nuk ia dija kuptimin. Por që në atë moshë hipokrizia duket më qe injektuar në gjak. Nëse dikush do të ma kishte shpjeguar ç'do të thoshte, mbase nuk do të isha bërë i tillë.

Askush nuk ma shpjegoi. Në shkollë, duke nisur nga klasa e parë, na jepnin mësimin e edukatës morale. Hipokrizinë nuk mbaj mend të na e ketë shkoqitur ndonjë mësues. Mbjaj mend diçka tjetër: ata ndryshe silleshin në mungesë të drejtorit, ndryshe në prani të tij. Shpesh ia hidhnin, e gënjenin në sytë tanë, por ne nuk ndiheshim. Xhodën e kishim edhe frikë, edhe inat. Në këtë pikëpamje as Xhoda nuk ndryshonte shumë nga mësuesit. Kisha vënë re se, kur vinte ndonjë inspektor, drejtori nuk sillej si zakonisht, bëhej i butë, i sjellshëm, gënjente dhe ia hidhte inspektorit pothuaj njëlloj siç e gënjenin dhe ia hidhnin atij mësuesit. Punët shkonin për bukuri. Ne rriteshim të bindur se ishim fëmijët më të lumtur në botë. Kështu thuhej në këngët që mësonim.

Megjithatë, unë kisha arsye për ta vënë në dyshim nëse ishim vërtet ne fëmijët më të lumtur në botë. Nuk e di ç'ndodhte me të tjerët, por unë, në shtëpi, shihja skena midis prindërve shpesh aq të stuhishme, sa më shkonin mornica. Për të zhdukur çdo keqkuptim, shënoje se im atë ishte njeri pa vese. Ai s'ka ditur ç'është alkooli e duhani dhe jam i bindur se as qejfli grash s'duhet të ketë qenë. Për më tepër nëna e ka sunduar gjithmonë. Ishte ekonomist, shef llogarie, kurse nëna rrobaqepëse. Përpiqeshin të mos grindeshin në praninë time, e kuptoja. Nuk ia dilnin gjithmonë.

Habitesha sepse në të shumtën e rasteve grindjet nisnin për vogëlsira. Me shokët e mi unë s'do të grindesha për vogëlsira të tilla. Sidoqoftë, stuhia shpërthente, një stuhi fjalësh me akuza e kundërakuza. I pari lodhej im atë. Pas tij, si shfrynte me vete, e mbetur pa partner, e kyçte edhe nëna. Atëherë, në qetësinë e shurdhër që pllakoste dhomën, dëgjoja tim atë që psherëtinte: “Zot, ç’jetë qeni”. Dhe unë arsyetoja se njeriu nuk mund të jetë njëkohësisht edhe më i lumturi në botë, si thuhej në një nga këngët që mësonim, edhe të bënte jetë qeni, si shprehej im atë. Këtë arsyetim e ngatërronte dhe e kthente pastaj në rebus diçka tjetër. Ka lidhje me aftësitë aktorese të prindërve të mi. Më vjen rëndë që shprehem kështu, por është e vërtetë. Prindërit e mi ishin aktorë.

Në pallatin tonë banonte njëfarë Hulusiu. Tani ka vdekur. Ishte një burrë shkurtabiq dhe te ne vinte shpesh. Mbaj mend se hante pa hesap, mund ta boshatiste një shishe me raki pa lëvizur vendit. Nga mënyra se si flisnin prindërit e mi për të, arrija në përfundimin se në rastin më të parë ata do ta kapnin e do ta flaknin nga dritarja. Kështu kisha dëgjuar të thoshte im atë. Këtë skenë të dëshiruar – e besoja, im atë mund ta hidhte nga dritarja Hulusiun, me trup ishte sa dyfishi i tij – fatkeqësisht nuk e pashë kurrë. Përkundrazi, kur prisja që babai ta kapte Hulusiun prej zverku, sapo ky dukej në derë, im atë vinte

buzën në gaz, nëna gjithashtu. Hulusiu dendej me raki dhe largohej kur i mbushej mendja. Sapo largohej ai, maskat e qeshura zhdukeshin në çast nga fytyrat e prindërve. Babai fuste duart në xhepa e niste ca ecejake nervoze poshtë e përpjetë dhomës. Nëna nxinte në heshtje. E pra, ky njeri kaq i përbuzur, Hulusiu, ka qenë engjëlli bamirës i familjes sonë. Pa ndihmën e tij, ime motër nuk do të mundte të ndiqte shkollën pedagogjike, kurse unë, më vonë, s'do të kisha asnjë shans për të vajtur në universitet. Por këto gjëra atëherë nuk i dija. Nuk e dija se fqinji ynë, Hulusiu, që banonte një kat sipër nesh, ishte i pari i qytezës. Nuk e dija se, për të fituar mbrojtjen e engjëllit bamirës, prindërit e mi paguanin një haraç të përhershëm: uljen e dinjitetit. Nuk dija edhe plot gjëra të tjera, të cilat jeta do të m'i mësonte një e nga një. Atëherë, dilemave të mëdha truri im u jepte një zgjidhje të thjeshtë, komode, me plot gojën mund ta quaj konformiste: të gjithë njerëzit ishin aktorë, edhe mësuesit, edhe prindërit. Ata hiqnin e vinin maska. Për analogji, edhe unë, njëlloj si të rriturit, duhej të përgatisja maskat e mia. Kjo qe dhe zgjidhja përfundimtare që i dha rebusit truri im. Për sa i përket dilemës nëse ne ishim apo nuk ishim fëmijët më të lumtur në botë, i dhashë një zgjidhje që mund të quhet origjinale. Edhe ishim, edhe nuk ishim. Si puna e qenve të qytezës. Sipas meje, bastardët

s'duhej të ishin të lumtur. Ata hanin shqelma ngado që futeshin, pa përmendur mëlçitë e helmatisura të babait të Sherifit. Përkundrazi, qentë shtëpiakë – në përgjithësi ata që kishin shtëpi private mbanin qen – sidomos konet, duhej të ishin të racës së të lumturve. Edhe Vilma mbante një kone. Të bardhë me qime të dredhura.

Vilma ishte drita e syve të Xhodës. Konia ishte drita e syve të Vilmës. Unë vendosa të helmoja konen e Vilmës.

3

Konen e bardhë të Vilmës e helmova për t'u hakmarrë. Ky veprim nuk kishte përmbajtje tjetër. Si fëmijë, vetja më dukej i barabartë me gjithë fëmijët në kuptimin që mund të ketë e mund t'i japë një dymbëdhjetëvjeçar barazisë shoqërore. Është jashtë çdo dyshimi se në atë kohë nuk kisha komplekse, veten nuk e futja në kategorinë e bastardëve, pra në specien e të pafatëve, as Vilmën në kategorinë e koneve, domethënë në specien e të lumturve. Që unë dhe Vilma u përkisnim specieve të ndryshme, do ta kuptoja më vonë. Kjo do të qe edhe trauma e dytë. Por atëherë isha nën pushtetin e traumës së parë, pas rrahjes, kur im atë humbi në sytë e mi. Për këtë duhej të paguante

konia e Vilmës. Që Vilma të qante ditë e natë. Që Xhoda të tërbohej nga marazi.

Ajo ishte një kone e bukur. Si të gjitha konet, dilte e lehte me të madhe te shufrat e kangjellës, ku nxirrte turinjtë, sa herë aty pranë kalonte dikush. Ashtu më lehu edhe mua. Ishte një pasdite e ngrohtë dhe Vilma po rrinte ulur në një karrige të vogël pranë shkallëve, e përqendruar në leximin e një libri. Prandaj, në lehjet e para, ajo nuk e ngriti kokën. Mirëpo unë nuk u tunda nga vendi dhe konia, që ishte vërsulur drejt meje, po ngrinte lagjen në këmbë. Kjo që diçka e llogaritur nga ana ime. E mërzitur, më në fund, Vilma ngriti kokën. Sytë e saj u ngulën në sytë e mi. Sytë e mi u ngulën në sytë e saj. Ishin të kthjellët si ujë deti. Njiheshim, por s'kishim folur ndonjëherë. Vazhdimisht kishim qenë në klasa të ndryshme paralele. Dhe, ç'është e vërteta, në ato çaste s'më hante fort merakun të flisja me Vilmën.

Në fillim ajo shtrembëroi fytyrën nga pakënaqësia dhe që tutje thirri diçka si "Maks, or ngatërrestar, eja këtu". Pastaj, meqë Maksi nuk kishte ndër mend t'i bindej, ajo u ngrit, la librin mbi karrige dhe pothuaj me vrap erdhi drejt nesh. Kisha mbetur si i shastisur. Maksi u qetësua vetëm pasi e zonja e mori në krahë. I skuqur, unë sajova një si buzëqeshje. Thashë se ajo kishte një kone shumë të bukur. "Ngavash, ma ktheu Vilma, i rritet mendja

kur dëgjon lëvdata dhe nga kënaqësia është gati t'ia ngulë dhëmbët kujtdo që kalon para shtëpisë.”

Befas ia krisa vrapit, u largova. Vilma mbeti prapa kangjellës me Maksin. Shumë vjet më vonë, duke e kujtuar këtë skenë, të cilën e mbante mend, ajo do të më shpjegonte se i qeshë dukur i çuditshëm. “Sesi më pe, sesi m’i ngule sytë. Më pas unë dilja te shkallët me Maksin, bëja sikur lexoja. Në të vërtetë prisja të kaloje ti, të më shihje edhe një herë me atë mënyrën e çuditshme. Asnjë djalë s’më kishte parë ashtu dhe unë nuk e kuptoja ç’ishte ajo dëshirë për të të pritur. Përshtypja se do të kaloje ndonjë ditë pranë kangjellës nuk m’u shqit kurrë, edhe kur ndiqje universitetin e në qytezë u hap fjala se bëje dashuri me një vejushë. Por ti s’u duke më. Kurse unë të prisja, megjithëse më helmova Maksin. Qava si të më kishte vdekur një njeri i afërm. Dhe prapë të prisja. E sigurt se ti s’do të dukesh më...”

Që nga çasti kur u largova duke ia krisur vrapit, edhe unë isha i sigurt se s’do të kaloja më andej. Kur Vilma e ngriti Maksin në krahë dhe zuri të më fliste, ndjeva se, po të rrija aty edhe pak, hakmarrjen s’do ta kryeja dot. Nuk di si ta shpjegoj, por ndjeva se, po të rrija edhe pak pranë Vilmës, t’i dëgjoja zërin, t’i shihja sytë, ta vështroja se si përkëdhelte turinjtë e konës, unë s’do të mundja ta helmoja Maksin.

Dhe, po të mos helmoja Maksin, Vilma s'do të qante. E, po të mos qante Vilma, Xhoda nuk do të plaste nga marazi.

Maksi pati një fund të dhimbshëm. Para se të kryenim krimin, Sherifi kërkoi prej meje të mësoja se cili ishte ushqimi që i pëlqente më tepër. Pas shumë peripecish, nëpërmjet një djali që shkonte shpesh te Vilma – ishin kushërinj – mësova se gjella më e preferuar e Maksit ishin mëlçitë e qengjit, të ziera. I gjeta. Fshehurazi të atit, Sherifi i gatoi me helmin e mëlçive të qenve bastardë. Maksin e vramë një pasdite, kur Vilma e kishte nxjerrë, siç e nxirrte shpesh, në shëtitje në kufijtë e qytezës, ku fillonin arat. Sherifi më tregoi se e kishte kandisur kollaj, ndërkohë që Vilma llafosej me një shoqe. Maksi kishte mbaruar menjëherë. Më pas gjithçka u rrokullis në mënyrë marramendëse.

Të nesërmen në mbrëmje në shtëpinë time erdhi Sherifi. Ai s'kishte qenë ndonjëherë tek unë dhe, me ta parë mbështetur në parmakun e shkallës, e mora me mend se diçka duhej të kishte ndodhur. Më shqetësonte edhe një fakt tjetër: atë ditë Sherifi s'qe paraqitur në shkollë. Dukej i trembur, m'u lut të dilja të bisedonim diku, ku të mos na shihte e të mos na dëgjonte njeri. Nuk ia prisha. Errësira na ndihmoi të shmangeshim fshehurazi nga qendra e qytezës. Pa rënë në sy mbërritëm afër lagjes së bregut të lumit ku zumë vend prapa

një ferre. Sherifi dridhej, pastaj filloi të qante, derisa mësova si qëndronte puna. Me t'u marrë vesh vrasja e Maksit, në qytezë ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme. Afër drekës – më sqaroi Sherifi – në shtëpinë time erdhi drejtori. Bashkë me të, dy policë. Kërkuan babanë. Nuk e di ç'lafosën jashtë, por im atë u kthye brenda tërë nerva dhe më hodhi duart në fyt. “Do të të mbys me duart e mia po ta kesh bërë ti atë punë”, më tha.

I mjeri Sherif, po vdiste nga frika. Ishte i sigurt se i ati do ta mbyste vërtet. Por ky tmerr s'qe gjë para një tjetri, ndoshta më të llahtarshëm. Edhe pse nuk qe paraqitur në shkollë, Fagu me klanin e tij kishte mundur ta gjente andej nga bregu i lumit. Të gjitha dyshimet binin mbi të. E kishin rrahur me kërcënimin se do ta vdisnin fare po të mos tregonte të vërtetën. Sherifi kishte mohuar gjithçka. Pikërisht kjo, domethënë që ai mohonte gjithçka, e bënte të pashpresë gjendjen e tij. Nuk e besonte as i ati, as Fagu. Në fund, me lot në sy, duke më puthur dorën – s'më shqitet nga mendja se si u përkul e më puthi dorën – Sherifi m'u lut ta shpëtoja. Përndryshe s'kishte rrugë tjetër, veç të mbytej në lumë.

Nuk m'u desh të mendohesha gjatë për të vendosur. Sherifi po vdiste nga tmerrri. Unë, që e kisha tërhequr në lojë, duhej të bëja diçka. Dhe kjo diçka qe të merrja fajin përsipër. E mora. Jo nga frika se mos ai mbyste veten, sido

që në ato kushte e besoja se mund ta bënte. Vendosa të pranoja autorësinë e krimit, sepse ndjeva që mund të duroja dhe vuajtjet e ferrit, por jo puthjet e pështira të dorës prej tij. Po të mos e merrja fajin unë, Sherifi do të vinte çdo ditë të më puthte dorën, si qen i rrahur.

Pohimin ia bëra Fagut. Kështu lajmi do të shkonte menjëherë atje ku duhej dhe unë do të kisha kohë të mjaftueshme për t'iu përgatitur shpirtërisht asaj që më priste. Fagu shqeu sytë, ishte pohimi më i pabesueshëm që dëgjonte. U bind vetëm kur i shpjegova se e kisha kryer vrasjen për t'u hakmarrë ndaj Xhodës. Të gjithë e dinin se Xhoda, para ca kohësh, më kishte kopanisur. Prandaj hakmarrja ime konsiderohej e ligjshme, qoftë edhe në këtë formë. Fagu s'mund të më prekte, ndryshe do t'i hapte punë vetes. Askush nga sherrxhinjtë e klanit të tij s'do t'ia falte nëse ai, për shkak të Vilmës, do të guxonte të më keqtrajtonte.

Kështu ndodhi. Në ato kohë Fagu ishte më i gjatë se unë dhe, pa dyshim, më i fortë. I inatosur, qeshi me përbuzje. Dhe u largua. Që nga ajo ditë jeta ime u bë e padurueshme. Në qytezë zunë të më shihnin si të isha kriminel. Në shkollë, para nxënësve të rreshtuar në oborrin e madh, gjesti im u quajt rrugaçëria më e padëgjuar e kryer në qytezë. M'u thyen dy nota në sjellje, u përjashtova tri ditë nga shkolla. Ndryshe nga ç'kisha parashikuar,

drurin e parë për këtë bëmë e hëngra jo nga Xhoda, i cili s'denjoi as të më thërriste në drejtori, por nga im atë. Ky s'më kishte rrahur ndonjëherë. Më rrahu me t'u kthyer nga rajoni i policisë, ku e kishin thirrur të jepte llogari për mua. Si mora vesh, atje i kishte paguar dëmshpërblimin Xhodës, një shumë të hollash rreth tre-katër mijë lekë. Dhe sot e kësaj dite nuk jam i qartë nëse im atë më ndëshkoi për gjestin, për paratë që iu desh të harxhonte, apo nga frika që i kishte hyrë në palcë kur e kishin thirrur në polici. Sidoqoftë, që nga ajo kohë im atë e mësoi këtë zanat. Por, nëse ai mësoi të më rrihte, unë u mësova të rrihesha. Dhe, kur njeriu mësohet me dru, nuk i hyn më në sy asgjë.

Mars 1991

“Mjjeran i shkretë”, thashë me vete kur Mi ktheva krahët Xhodës e ai mbeti në hyrje të varrezës me shufrën e hekurit në dorë. “U dashka t’i ngrys ditët me ty.” Dhe mendova se njëri nga ne ishte krijuar për të torturuar tjetrin. Tek ecja në rrugën me pluhur, u orvata të gjeja në isha unë i paracaktuar nga providenca si mallkim për Xhodën në ditët e çmendurisë, apo çmenduria e tij qe parathënë për të më kujtuar në çdo çast se unë s’do të gjeja prehje kurrë.

Më erdhi të qaja. Kjo tregonte se vështrimi gjak i syve të Xhodës më kishte bërë esëll. Qielli i pistë si çarçaf i palarë më kujtoi ikanakët në det. Dhe befaz m’u bë sikur ndjeva erë urine. Të ishte era e urinës së djalit të Dorit? Mbase qe era e lotëve të mi.

Po qaja. Kjo do të thoshte se pija më kishte dalë. Ndoshta qaja për ikanakët në det. Dhe vajta përsëri në klub. Ndërkaq, për fatin tim të keq, konjaku qe mbaruar. S'mbetej rrugë tjetër përveç qebaptores "Bregu i lumit". E gjeta mbyllur, atë ditë s'qe hapur fare. Duket se ish-brigadieri i fabrikës së çimentos, Arsen Mjalti, po vinte dhjamë dhe si jo shumë kolegë të tjerë, i lejonte vetes luksin e pushimit të së dielës.

Me gjithë sasinë e konjakut të pirë, qyteza sikur vazhdonte të bënte gjumin e vdekjes. Më hipi edhe një herë të dilja në qendër e të vija ulërimën: "Bashkëqytezarë të nderuar, zgjohuni! Që sot e tutje jeni qytezarë të lirë, mund të bridhni nga të doni e kur të doni. Liria e shumëpritur erdhi dhe tani mund të arratiseni nga toka, deti dhe ajri. Kurrkush s'do t'ju quajë tradhtarë, kurrkush s'do t'ju cilësojë huliganë. Drejtësia sociale ngadhënjeu."

Nuk ulërija, as në qendër s'vajta. Edhe për të qarë s'më vinte më e kjo do të thoshte se isha dehur përsëri pa pirë. Atëherë vura re të kalonte përmes qytezës Xhoda i Marrë. E ndoqa. Deri pranë shtëpisë. Ai u fut brenda, humbi në gojën e zezë të hyrjes. Për një çast, s'di si m'u fanit, por pata përshtypjen se nga ajo gojë e zezë doli duke lehur një brumbull i bardhë. M'u zu fryma, mbulova fytyrën me duar. Maksin e kisha vrarë tridhjetë vjet të

shkuar. Ai s'mund të ishte Maksi. Mbështeta kokën në trungun e pishës aty pranë dhe më erdhi për të vjellë. Sikur befas të kisha gëlltitur një copë mëlçie me helm. Volla. Kur ngrita kokën, përmes qerpikëve të lagur, pashë tutje Xhodën e Marrë ulur në karrige, në krye të shkallëve, me shufrën e hekurit në dorë. Ik, mjeran, desha t'i thërras, sfinks tragjik. Kë ruan?

Pisha ishte tridhjetë vjet më e re. Unë aq i hollë në trup, sa të fshihesha pas trungut të saj. Vilma rrinte në karrige, lexonte libër. E përgjoja prej më se një ore, por ajo s'e kishte ngritur kokën asnjëherë. Maksi nuk mund të vraponte të lehte te kangjella. E kisha vrarë. Rrija i fshehur pas trungut të pishës i sigurt se Vilma e dinte që ndodhesha aty. Së fundi, në një çast kur e humba mendjen, ndjeva diçka që ra pranë këmbëve të mia. E mora. Ishte një guriçkë e mbështjellë me letër. “Je penduar për atë që bëre, këtë do të më thuash? Nuk është nevoja. Ke pesë ditë me radhë që vjen e fshihesh pas trungut të pishës, si hajdut. Edhe nëse vërtet je penduar, nuk të fal. Ç’pate me Maksin? O Zot, ç’të bëri? Sikur ta dish sa të urrej!”

Kur ngrita kokën, karrigia ku qe ulur Vilma ishte bosh. Ky është imazhi i fundit që jam në gjendje të riprodhoj nga vitet e fëmijërisë. Gjithçka tjetër është fshirë. Ka mbetur vetëm karrigia bosh si për të më kujtuar se jeta ime do të ishte e tillë, bosh. Nuk ndieja pendesë për veprimin e kryer. Kur lexova pusullën e Vilmës, nuk e kuptova përse ajo mendonte kështu. Dëshira ime për të parë, i fshehur pas trungut të pishës, bashkën e artë të flokëve të saj, nuk kishte lidhje me ndonjë pendesë. Por, meqë Vilma më shprehu urrejtjen, s'mbetej tjetër veç të ikja, për të mos u kthyer më. Mposhtja e dëshirës për të vajtur të vështroja fshehurazi, pas trungut të pishës, bashkën e artë të flokëve të Vilmës, m'u kthye në vuajtje kur në këtë mes hyri kompleksi i inferioritetit. Pragun e fëmijërisë e kapërceva pikërisht me këtë zbulim: ekzistonte një ndjenjë që njerëzit e quanin inferioritet.

Ndodhi në një nga ato netët kur kryetari i qytezës, Hulusiu, pasi u dend me raki, duke iu marrë këmbët e me gjuhë të trashur u ngjit t'ia këpuste gjumit një kat më sipër, kurse në apartamentin tonë, përveç avujve të alkoolit dhe rrëmujës mbi tryezë, la nervozizmin e prindërve të mi. Me syrin e sotëm mund të them se gjithçka ndodhte para meje në raste të tilla ishte një tragjikomedi. Qëllonte madje të zbavitesha nga batutat e prindërve. Por ajo natë qe një çmenduri. Duket për herë të parë

e të fundit, për arsye që vetëm ai mund t'i dijë, im atë e shoqëroi Hulusiun gotë më gotë. Më kujtohet se si nëna hynte e dilte në kuzhinë e shqetësuar, derisa burrat u dehën. Ndryshe nga Hulusiu, që fliste tërë kohën, babai e dëgjonte në heshtje. Mbase nuk e dëgjonte fare. Kur ky u largua dhe nëna mbylli derën, babai bëri një gjest të shëmtuar me dorë, kuptimin e të cilit, si djalë qyteze, unë e kisha mësuar prej kohësh. Nuk ia vlen ta shpjegoj. Pas gjestit e zuri lemza dhe u fut në kuzhinë ku mbajti pak a shumë këtë ligjëratë: “Nëse yt vëlla s’do të ishte kodosh, mua s’do të ma nxinte jetën një kodosh tjetër. Mirëpo yt vëlla, si kodosh kodoshi, më la dopio gjashtë në dorë e unë s’di nga ta çoj. I bie në të kush është dopio gjashta?”

Nëna lëshoi një klithmë. Kjo mjaftoi ta bënte babanë esëll. Pas klithmës nëna u derdh jashtë kuzhinës, u mbyll në dhomën e gjumit. Babai mbeti si një trung i goditur nga rrufeja. Në qoshen ku ndodhesha mbi divan, s’dija ç’të bëja. Po mbase eksitimi nervor i tyre kishte arritur në atë shkallë sa prania ime ishte e papërfillshme për të luajtur ndonjë rol frenues. Babai çoi dorën lart, mbi fytyrë. Iu afrua tryezës, u ul rëndshëm në karrige dhe atëherë, duke ndier të më thahej pështyma në grykë, pashë se si im atë u shkreh në dënesë. Trupi i tij i madh, rënë përmbys, dridhej. E tërë tryeza dridhej, madje m’u bë se tundeshin muret.

Qëndrova në mëdyshje midis dëshirës për t'u zhdukur dhe frikës se mos babai ngrinte kokën dhe më shihte aty. Së fundi, majë gishtërinjve, me lotët që po më mbytnin, arrita të dilja nga kuzhina. Pa u ndier, u mbylla në dhomën time. Aty u shkrija në vaj. Nga ligjërata e tim eti s'kisha kuptuar asgjë; nëna kishte lëshuar vetëm një klithmë. Megjithatë, në skenën e asaj nate, ndryshe nga mjaft skena të tjera të zakonshme midis prindërve të mi, kishte diçka të rëndë. Më pas nuk kam dashur të zhytem në kuptimin e fjalëve të babait. As në kuptimin e klithmës së nënës. Sipas meje, nuk është e drejtë të zhytesh në intimitetet e jetës së prindërve. Mbaj mend se, tek rrija i mbështetur pas derës së dhomës, i tronditur nga dënosa e babait, ndjeva zërin e tij në korridor. U bëra i tëri vesh. Im atë i lutej nënës ta falte. Me zë të ulët, duke psherëtirë, ai përbetohej se nuk do ta përsëriste më atë që bëri, se qe e para dhe e fundit herë që dehej. Dukej nëna nuk i përgjigjej, si priste pak në heshtje, babai ua niste përbetimeve nga e para. S'mund të them ç'ndieja në ato çaste për të, mëshirë apo neveri. Nëna nuk ia hapi derën. Atë natë ai fjeti në kuzhinë, gërhimat ia dëgjoja gjatë. Tek dëgjoja gërhimat e tij, përpiqesha të bindja veten se tashmë nëna s'kishte ndonjë arsye për të ndenjur zgjuar.

Gjumi duhet të më ketë zënë ndaj të gdhirë. Kur u zgjova, dielli kishte mbytur dhomën. Kjo do të thoshte se atë ditë shkollës i qe vënë vizë,

prindërit më kishin lënë të flija. Ndihesha ende nën pushtetin e skenës së një nate më parë. Për habinë time edhe prindërit i kishin vënë vizë punës: i gjeta në kuzhinë, përballë njëritjetrit, duke pirë kafe. Dreqi e merr vesh ç'qe ajo egërsi që më pushtoi kur i pashë të dy tek surbnin kafënë qetë-qetë, sikur një natë më parë midis tyre të mos kishte ndodhur asgjë. Përkëdheljet e tyre më acaruan, siç acarojnë ngacmimet një kafshëz të mbyllur në kafaz. Sa më të dashur silleshin me mua, aq më inat i merrja. Më vinte të ulërija, të thyeja diçka, të formuloja sharjet më të ndyra, të pështyja, të ngërdheshesha, të nxirrja gjuhën jashtë, me një fjalë të vija në përdorim arsenalin e të gjitha veprimeve të ndaluara. Dhe ishin aq naivë sa të mos vinin re asgjë. Po ndoshta edhe unë nuk u lashë shkas t'u shkante mendja për keq. U bëra vetëm një pyetje. U kërkova të dija se cili na qenkësh ky vëlla i nënës. Deri atë ditë unë nuk dija që nëna të kishte një vëlla, nuk dija që unë të kisha një dajë.

Nënës i ra filxhani nga dora. Babai u zbeh. Tekefundit qe e thënë ta mësoja kështu, në moshë të njomë, se bëja pjesë në kategorinë e njerëzve inferiorë, ose, siç e përfytyroja aso kohe, në kategorinë e bastardëve, të atyre qenve zgjebanjosë që i përzënë me shqelma ngado që futen. Pa e zgjatur, me një zbehtësi prej të vdekuri, babai më shpjegoi se unë vërtet kisha një dajë. “Disa muaj pas lindjes sate,

më sqaroi ai, yt ungj, i cili kryente shërbimin ushtarak në një pikë kufitare, bashkë me dy shokë të tjerë, kaloi matanë kufirit. Është i arratisur, armik, turpi i familjes sonë. Për të gjithë ne, pra edhe për ty, ai nuk ekziston. Dhe duhet ta urresh!”

Kështu e përfundoi sqarimin babai, me porosinë të urreja një njeri që, deri në ato çaste nuk e dija madje se ekzistonte. Por në këtë pikë, domethënë që unë ta urreja atë njeri, megjithëse vëllai i nënës dhe im ungj, babai s’kishte nevojë të këmbëngulte fort. Në përfytyrimet tona fëmijërore i arratisuri ishte një qenie e përbindshme. Njihja një djalë në qytezë me vëlla të arratisur. E quanin Riku. Djemtë i shmangeshin, askush s’kishte qejf të shoqërohej me të, si të vuante nga një sëmundje e keqe dhe ruheshin mos ua ngjiste. Unë bëja si të tjerët, i shmangesha. Edhe shtëpia e Rikut, një ngrehinë përdhese e mbuluar me tjegulla, në skaj të qytezës, ishte e vetmuar, larg rrugëve, në fushë të hapur. Një mister i frikshëm e mbështillte atë ngrehinë ku as hynte, as dilte njeri e ndoshta për këtë arsye ajo na dukej si shtëpi të vdekurish. Prandaj im atë s’kishte nevojë të këmbëngulte shumë që të urreja një të panjohur. Mjaftonte fjala “i arratisur”.

Vështirë që prindërit të kenë kuptuar efektin që bëri tek unë ky zbulim. E vetmja gjë e vërtetë është se atë çast mua më vajti

mendja te Vilma. Qe e pamundur që prindërit të bënin një lidhje midis zbehjes së fytyrës sime dhe përfytyrimit të Vilmës. Atë çast unë thashë me vete se tani s'mund të shkoja më të përgjoja i fshehur pas trungut të pishës vezullimin e flokëve të saj. Kisha një dajë të arratisur dhe, si i tillë, e gjykova veten të padenjë të fitoja simpatinë e Vilmës. Por kjo s'merrej dot me mend nga prindërit e mi. Përkundrazi, im atë u kujdes të më jepte një porosi kategorike: për dajën askund, askujt, asnjëherë, asnjë fjalë. Këto m'i tha duke m'i ngulur sytë thellë. Ndërkohë që ai më mbante mbërthyer me vështrimin hipnotizues, m'u fanit shtëpia e Rikut, e zhytur në vetmi. Më doli para syve dhe vetë Riku, vazhdimisht i frikur dhe rrëshqitës si hije. Nëse thjesht në kuptimin fetar prindërit e mi kanë ndonjë mëkat ndaj meje, ky i takon asaj dite. Dhe është i dyfishtë. Ata më kërkuan të urreja një të panjohur, megjithëse ishte im ungj. Ata më kërkuan të urreja heshturazi, fshehurazi. Në këtë mënyrë, në kuptimin fetar të fjalës, edhe unë u shtyva në rrugën e mëkatit. Disa ditë më parë kisha mbytur Maksin. Ky krim prej fëmije nuk e rëndoi ndërgjegjen time. Pata guximin ta pranoja me të gjitha pasojat. Në këtë pikëpamje them se vrasja e Maksit nuk mund të quhet mëkat dhe, meqë deri atë ditë s'kisha bërë ndonjë mëkat tjetër, nuk ishte ky mëkati im i parë. E quaj veten mëkatar

që nga çasti kur im atë kërkoi prej meje të urreja një njeri të panjohur. Doemos, unë nuk mund të urreja një fantazmë. As haptazi, as heshturazi. U futa në rrugën e deformimit shpirtëror, pra të mëkatit të përhershëm, kur zura të mbaja përbrenda një të fshehtë përvëluese, të frikshme, të rrezikshme. M'u bë e qartë se këtë të fshehtë e ruanin rreptësisht edhe prindërit e mi. Ata qenë vendosur në qytezë fill pas arratisjes së ungjit të famshëm biografiprishës. Me shpresën që të shmangnin njollën kanceroze. Nuk e di se si, por ia kishin arritur.

Që nga ajo ditë bota për mua shfaqej në dy ngjyra: bardhë e zi. Përbëhej nga dy bashkësi: e të bardhëve (Vilma) dhe e të zinjve (unë). Që nga ajo ditë unë jetoja në mënyrë iluzive në universin e bashkësisë së të bardhëve kur e dija mirë se i përkisja bashkësisë së të zinjve. Nisi kështu jeta ime e dyfishtë, me kompleksin e përhershëm të fajit. Dhe ëndrra që zuri të ngjizej brenda meje, si nevojë për të shpëtuar nga qorrsoakaku, qe dëshira për arrati. Jo në kuptimin e arratisë fizike. Këtë e kisha provuar dhe ia dija shijen. U arratisa brenda vetes, në trojet e vetmisë. Nuk ka arrati më të zymtë. Por edhe më të sigurt nuk ka. Më tej jeta ime u rrokullis në banalitetin e pluhurosur të qytezës, përmes një monotonie gjumëndjellëse që prishej herë nga druri i Xhodës në shkollë, herë nga druri i babait në shtëpi, herë nga druri

i të dyve bashkë. Por edhe druri e pati një fund. Këtë fund nuk mund ta datoj. Nëse mbaj mend mirë dajakun e parë, përkatësisht të Xhodës dhe të babait, nuk mund të them se kur secili prej tyre më dha dajakun e fundit. Është e kuptueshme, në ndryshim nga ndëshkimi i parë fizik, ndëshkimi i fundit nuk duhet të ketë pasur rëndësi, nuk më ka lënë gjurmë. Sepse bënte pjesë në rutinën e së përditshmes. Dhe u fshi pa u vënë re. Një gjë mund ta them me siguri. Kjo përkon me fillimin e asaj periudhe të jetës, kur Vilma pothuaj zhduket, si zhduket Fagu, Xhoda, prindërit, e tërë qyteza. Kjo periudhë më është fshirë nga kujtesa siç është fshirë druri i fundit, pa lënë mbresë. Për arsye që merren me mend, shkollën e mesme nuk e ndoqa në qytezë. Mundësia e zbulimit të minës biografike me sahat, që do ta hidhte në erë të ardhmen time, kështu ishte më e vogël. Larg qytezës, larg njerëzve që më njihnin, larg atyre për të cilët mund të isha konkurrent. Ky parim i ndjekur më parë për motrën, u ndoq edhe për mua. Me ndihmën e engjëllit shpëtimtar, Hulusiut. Bamirësit tonë të përjetshëm. Në këtë pikë zhduket, pa hyrë kurrë në jetën time, edhe ky njeri enigmatik, me lidhje edhe më enigmatike me prindërit e mi. Lidhje që s'më interesuan ndonjëherë. Në saje të tij më pranuan në një shkollë të mesme të Tiranës. Ishte ai që më rregulloi të drejtën e studimit në universitet,

në degën kimi industriale. Vdiq papritur, tre muaj pasi kisha filluar studimet. Në varrim nuk i vajta, por urova t'i shkonte shpirti në parajsë. Shpresoj t'i ketë shkuar. Ndërkaq, në jetën time kishte hyrë Ladi.